



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
Zëdhënësi i Shtypit

DEKLARATË PËR SHTYP
E MINISTRIT TË FINANCAVE ZOTIT KASTRIOT ISLAMI

Bisedimet me Misionin e FMN-së,
15-23 Korrik 2003

1. Më lejoni fillimisht të rideklaroj zyrtarisht nivelin shumë të mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit me FMN dhe të angazhimit serioz e permanent të qeverisë shqiptare për të përmbushur angazhimet e marra në kuadrin e memorandumit të Politikave Ekonomiko-Financiare me FMN. Theksoj se këto marrëdhënie kanë shënuar progres vitet e fundit dhe paralelisht me këtë progres ka shënuar rritje edhe cilësia e tyre.
2. Gjatë periudhës 15-23 korrik, misioni teknik i ekspertëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar i kryesuar nga Z. Hussein Samiei zhvilloi diskutime me stafin drejtues të Ministrisë së Financave dhe kreu një sërë takimesh me drejtues dhe specialiste të Ministrive të Linjes, Bankën e Shqipërisë etj në kuadrin e monitorimit të programit të Strategjisë për Reduktimin e Varfërisë dhe Rritjes Ekonomike (PRGF).
3. Çështjet kryesore që u diskutuan gjatë këtij raudi bisedimesh përfshinë:
 - Zhvillimet dhe perspektivat makro-ekonomike;
 - Politikat në sektorin monetar e financiar;
 - Vlerësimi i performancës buxhetore për 6-mujorin e parë të vitit 2003 dhe parashikimi deri në mbylljen e vitit 2003;
 - Diskutimi i projekt buxhetit afatmesëm 2004-2006;
 - Informim dhe diskutim për çështjet kryesore të privatizimit të INSIG e të Bankës së Kursimeve;
 - Ecuria e sektorit të energjitikës;
 - Ecuria e programit të shlyerjes së detyrimeve reciproke të ndërmarrjeve shtetërore.

Situata Makroekonomike:

4. Gjatë diskutimeve me misionin u arrit në përfundimin se stabiliteti makroekonomik është ruajtur duke vlerësuar se programi për një rritje ekonomike deri në fund të vitit me 6% dhe normë mesatare të inflacionit 3% është mëse realist, kjo mbështetet nga ecuria dhe performanca e sektorëve kryesorë të ekonomisë si bujqësia, ndërtimi, shërbimet, transporti dhe industria. Rritja e fortë e eksportit me mbi 42% gjatë 5-mujave të parë të këtij viti është tregues sinjifikativ i rritjes ekonomike.

Politikat fiskale:

5. Realizimi i të ardhurave të buxhetit gjatë 6-mujorit të parë të këtij viti është në nivel të kënaqshëm. Vlen të përmendet se është bërë progres në rimbursimin e TVSH-së, duke mos krijuar borxhe të reja si dhe është bërë një program për rimbursimin e detyrimeve të vjetra 1996-2001. Të dy administratat fiskale janë të angazhuara dhe kanë marrë të gjithë masat për të realizuar jo vetëm objektivat e 6 mujorit të dytë por përmirësuar edhe rezultatin vjetor konform objektivave.

6. Gjithashtu janë hedhur hapa progresi në drejtim të zbatimit të reformës si për shëmbull ngritja e njësisë së pas zhdoganimit në dogana, rritja e numrit të taksapaguesve, kompjuterizimi i sistemit të administrimit të tatimit mbi fitimin, implementimi i sistemit ASYCUDA në dogana, informimi i publikut lidhur me procedurat tatimore dhe legjislacionin fiskal, e tjerë.

7. Marrëdhëniet me biznesin perceptohen të përmirësuara dhe janë kryer një sërë përmirësimesh procedurale që kanë përmirësuar klimën miqësore ndaj komunitetit të biznesit.

8 Një plan rezervë shpenzimesh, si një nga kushtet prioritare të marrëveshjes shtesë të diskutuar nga Bordi i Drejtorëve Ekzekutivë të FMN në qershor 2003, është përgatitur dhe do të implementohej eventualisht në rast se të ardhurat totale nuk do të realizoheshin sipas programit duke përcaktuar kursime për zërat e a) subvencionit të energjisë; b) të fondit rezervë dhe kontingjencës dhe c) të shpenzimeve administrative e operative.

9. Deri në fund të vitit vëmëndja do të fokusohet jo vetëm në marrjen e masave për realizimin e planit të të ardhurave nga tatimet dhe doganat, por edhe në mbajtjen e të njëjtit ritëm në përmirësimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve me biznesin, forcimin e procedurave të Komisionit të Apelit të tatimeve dhe informimin e vazhdueshëm të publikut mbi procedurat ligjore. Përfundimin e transferimit të funksionit të mbledhjes së kontributeve shoqërore nga ISSH tek Tatimet, etj.

10. Në Projekt Programin Afatmesëm Buxhetor 2004-06 janë përcaktuar objektiva që synojnë ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, konsolidimin e mëtejshëm fiskal dhe maksimalizimin e efikasitetit të shpenzimeve. Do të synohet të ruhet ritmi i lartë vjetor i rritjes së të ardhurave totale fiskale e buxhetore i arritur për herë të parë gjatë vitit 2003 edhe për vitet 2004-2006. Shpenzimet do të rriten me ritëm rreth 10 përqind në vit duke patur njëkohësisht objektiv prioritar uljen progresive në terma të PBB të deficitit buxhetor. Në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim Ekonomik dhe Social sektorë prioritarë do të vazhdojnë të jenë: arsimi, shëndetësia, çështjet sociale.

11. Progres është programuar të realizohet në drejtim të përmirësimit të procedurave buxhetore dhe transparencës së përdorimit të fondeve publike si: (i) detajimi i mëtejshëm i zërave të buxhetit; (ii) zvogëlimi gjatë vitit i rialokimeve të fondeve brënda institucionit dhe nga një institucion në tjetrin; (iii) futja brenda sistemit të thesarit të të gjithë fondeve ekstrabuxhetore; (iv) përgatitja e buxhetit në një kohë më të shkurtër dhe vënia në dispozicion të Parlamentit për diskutim për një periudhë më të gjatë kohore.

12. Dua të theksoj gjithashtu edhe progresin e bërë në drejtim të shlyerjes së detyrimeve reciproke midis ndërmarrjeve shtetërore proces i cili ka vend të përmirësohet më tej si edhe një nga kriteret e performancës së vendosur nga FMN për Qeverinë Shqiptare.

13. Në kuadrin e reformave strukturore është diskutuar lidhur me (i) privatizimin e Bankës së Kursimeve, ku u vlerësuan hapat e ndërmarrë nga grupi i privatizimit në Ministrinë e Financave dhe Banka e Kursimeve në plotësimin e planit të veprimeve për ristrukturimin e përgatitjen e bankës për privatizim, fillimin e procesit të marketingut dhe tërheqjen në interesim të disa bankave prestigjioze, hapa për zgjidhjen përfundimtare të liberalizimit të shërbimit të buxhetit dhe thesarit etj. (ii) zgjidhjen e problemeve financiare dhe ligjore të Albtelekomit, (iii) negociatat me institucionet financiare ndërkombëtare IFC dhe BERZH për transferimin e 39% të aksioneve të INSIG tek to, negocijimin e cmimit të aksioneve të INSIG me një vlerë mbi cmimin e vlerësuar nga kompania ndërkombëtare audituese, (iv) përmirësimi i situatës në sektorin energjitik etj.

14. Misioni vlerësoi si pozitiv faktin se gjatë periudhës midis dy misioneve (Prill 2003 - Korrik 2003) Qeveria është përkushtuar në plotësimin e të gjithë objektivave të vendosur në Memorandumin e Politikave Ekonomiko-Financiare të Qeverisë shqiptare me FMN.

15. Në përfundim të këtyre bisedimeve, duke vlerësuar komunikimin transparent dhe bashkëpunimin e suksesshëm me misionin e FMN dua të rikonfirmoj edhe në emër të Qeverisë shqiptare marrëdhëniet e shkëlqyera dhe frymën e mirëkuptimit që ekziston mes dy palëve.

Tirane, me 23.07.2003